



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 1895/Prot.  
2

Tiranë më 16.12.2019

REKOMANDIM

Nr. 69, datë 13.12.2019

PËR KONTROLLUESIN *“AGJENCIA SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE  
MBROJTJEN E FËMIJËVE”*

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1, dhe 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit *“Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”*,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 338 datë 27.11.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit *“Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”*, me objekt:

- Zbatimi i neneve 18 dhe 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

*Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve* është person juridik në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit *“Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”* konstatoi se:

1. Kontrolluesi nuk ka *“Njoftuar”* Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1 të nenit 21 dhe nenit 22 të ligjit nr. 9887/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar: *"...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë"*.

2. Kontrolluesi nuk ka vendosur një rubrikë *"Politikat e privatësisë"* në portalin <http://www.ashdmf.gov.al>, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë këtë portal. Informacioni i publikuar në *"Politikat e Privatësisë"*, duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit, pika 1: *Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale...*" dhe Vendimit nr. 6/2013 *"Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale"*.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit hartoi dhe nënshkroi në prani të palëve procesverbalin e hetimit administrativ. Lidhur me konstatimet e grupit kontrollit, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk patën kundërshtime, por u shprehën se nga institucioni do ndërmerren masa për rikuperimin e tyre.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 21, 29, 30, 31 dhe 32 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar,

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi *"Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve"* në zbatim të neneve 21 dhe 22, të ligjit nr.9887/2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, të kryejë pranë Zyrës së Komisionerit *"Njoftimin"* në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës.
2. Kontrolluesi *"Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve"*, në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*, të informojë subjektet e të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale, qëllimin e përpunimit, mjetet dhe mënyrat e përpunimit, përhapjen e të dhënave etj., nëpërmjet *"Politikës së Privatësisë"* në portalin zyrtar.
3. Kontrolluesi *"Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve"*, të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e

marra. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.

4. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13.12.2019.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

